



VENDIM

Nr. 78 Datë 15.06.2012

PËR

**KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES “HEC MARTANESH” I
SHOQËRISË ALBANIAN POWER SI BURIM I RINOVUESHEM
ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma “l”, 9 dhe 39 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 7 dhe 9 pika 2 gërma “a” të Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 9, datë 21.02.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 15.06.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ALBANIAN POWER” sh.p.k për kualifikimin e impiantit prodhues për “HEC MARTANESH” si burim i rinovueshëm energjie,

Konstatohet se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “ALBANIAN POWER” sh.p.k, është konform Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme si më poshtë:

• **Neni 7, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i sakte dhe i plote.

• **Neni 7, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

• **Neni 7 pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”**

Përshkrimi i centralit...

Ky dokumentacion është dhënë i sakte dhe i plote.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI :

1. Të kualifikojë impiantin prodhues “HEC MARTANESH” të shoqërisë “ALBANIAN POWER” sh.p.k, si burim i rinovueshëm energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI